



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
KESHILLI MBIKQYRES UJESJELLES KANALIZIME SH.A. DURRES

V E N D I M

Nr. 2 Date 17.01.2006

Keshilli Mbikqyres i Ujesjelles Kanalizime Sh.A. Durres i miratuer me Urdherin e Ministrit Pronar nr. 32 date 13.01.2006, Per ndryshim ne Keshill Mbikqyres te Sh.A. ujesjelles Kanalizime Durres, mbeshtetur ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare, neni 98, si dhe ne ligjin 7926, date 20.04.1995 Per transformimin e ndermerrjeve shteterore ne shoqeri tregtare, ne mbledhjen e dates 17.01.2006 me vota te plota ;

V E N D O S I

1. **Z. Artan Zaimi**, deri tani ne detyren e Drejtorit te Ujesjelles Kanalizime Sh.A. Durres, lirohet nga kjo detyre.
2. Marredheniet e punes ne kete pozicion nderpriten ne daten 18.01.2006
3. Sektorët perkates te shoqerise te kryejne veprimet konform rregullave.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KESHILLI MBIKQYRES

Gafur Muka

Kryetar

Florian Pustina

Anetar

Dilaver Tepelona

Anetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Keshilli Mbikqyres
Ujesjelles Kanalizime Sh.A Durres

V E N D I M

Nr. 3 Date 18.01, 2006

Keshilli Mbikqyres i "Ujesjelles Kanalizime" Sh.A. Durres i miratuar me Urdherin e Ministrit Pronar nr.32, date 13.01.2006, "Per ndryshim ne Keshill Mbikqyres" te Sh.A "Ujesjelles Kanalizime" Durres, mbeshtetur ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", neni 98, si dhe ne ligjin 7926, date 20.04.1995 " Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare"; ne mbledhjen e dates 18.01.2006 me vota te plota;

VENDOSI:

1. **Z. Kurt EKONOMI**, emerohet Drejtor i "Ujesjelles Kanalizime" Sh.A Durres,.
2. Marredheniet e punes ne kete pozicion fillojne ne daten 18.01.2006.
3. Sektorët perkates te shoqerise te kryejne veprimet konform rregullave.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KESHILLI MBIKQYRES

Gafur Muka

Kryetar

Florian Pustina

Antar

Dilaver Tepelena

Antar

REPubLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E UJESJELLES-KANALIZIME Sh.A. Durres
KESHILLI MBIKQYRES

V E N D I M

Nr. 2, date 12.04 2007

Mbeshtetur ne Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e Ndermarrjeve Shtetore ne Shoqeri Tregtare" i ndryshuar, si dhe Vendim nr.642, date 11.10.2005, "Per Keshillat Mbikqyres te Shoqerive Anonime Shtetore",

Keshilli Mbikqyres i "Ujesjelles - Kanalizime" Sh.A, Durres, i miratuar me aktin e Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes nr. 32, date 13.01.2005, i mbledhur sot ne daten 12.04.2007, vendosi:

Z. Kurt Ekonomi, me detyre Drejtor i "Ujesjelles - Kanalizime" Sh.A, Durres lirohet nga kjo detyre me kerkesen e tij.

Marredheniet e punes ne kete pozicion nderpritin ne daten, 13.04 2007.

Z. Agron Islamaj, me detyre Kryeinxhinier i Ujesjelles - Kanalizime Sh.A. Durres, komandohet dhe Drejtor i "Ujesjelles - Kanalizime" Sh.A. Durres.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Keshilli Mbikqyres

Florian Pustina

Halit Xhafa

Thanas Liti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E UJESJELLES –KANALIZIMEVE Sh. A. Durres
KESHILLI MBIKQYRES

VENDIM

Nr. 1, date 20.01. 2010

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtarete dhe Shoqerite Tregtare”, ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 “Per transformimin e Ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregtare” i ndryshuar, si dhe V.K.M. nr. 642, date 11.10.2005, “Per Keshillat Mbikqyres te Shoqerive Anonime Shteterore”, ndryshuar.

Keshilli Mbikqyres i “Ujesjelles – Kanalizime” Sh. A. Durres, i miratuar me aktin e Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, nr. 32, date 13.01.2005, i mbledhur sot ne daten 20.01.2010, vendosi

Z.Agron Islamaj, lirohet nga komandimi ne detyre si Drejtor i “Ujesjelles – Kanalizime” Sh.A. Durres.

Marredheniet e punes ne kete pozicion ndërpriten ne daten, ____ . ____ . 2010

Z.Doklead Ademi, emerohet Drejtor i “Ujesjelles – Kanalizime” Sh.A. Durres.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Keshilli Mbikqyres

Halit Xhafa


Florian Pustina

Anila Dibra





REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEJA AKSIONEREVE
KESHILLI MBIKQYRES U.K.SH.A.
DURRES



Nr. 11 Prot.

Date 16/10 /2013

VENDIM

Keshilli Mbikqyres i mbledhur sot me date 16/10 /2013, ne zbatim te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, nenit 8,9 te vendimit nr. 271, date 9.5.1998 "Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore" i ndryshuar, Vendim nr. 642, datë 11.10.2005 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore" i ndryshuar, Udhezimit nr.965, datë 11.12.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore".

VENDOSI

Te liroje nga detyra Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise U.K.sh.a Durres z.Doklead ADEMI sipas kerkeses se tij.

Ngarkohet U.K.sh.a Durres per zbatimin e ketij urdheri.
Duke ju falenderuar per mire kuptimin.

KESHILLI MBIKQYRES

Z.Adrian ÇELA
Z.Sotir NGRESI
Z.Kujtim RUÇI
Z.Krenar HASANAJ
Z.Indrit BUKA

KRYETAR
N/KRYETAR
ANETAR
ANETAR
ANETAR



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEJA AKSIONEREVE
KESHILLI MBIKQYRES U. K. SH.A.
DURRES

Nr. 14 Prot.

Date 16/10/2013

VENDIM

Keshilli Mbiqyres i mbledhur sot me date 16/10/2013, ne zbatim te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, nenit 8,9 te vendimit nr. 271, date 9.5.1998 "Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shtetërore" i ndryshuar, Vendim nr. 642, datë 11.10.2005 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore" i ndryshuar, Udhezimit nr.965, datë 11.12.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore".

VENDOSI

Te emroje ne detyre Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise U.K.sh.a Durres z.Spartak KOVAÇI duke filluar nga data 16.10.2013. Me page bruto 150.000 leke.

Ngarkohet U.K.sh.a Durres per zbatimin e ketij urdheri.

Duke ju falenderuar per mire kuptimin.

KESHILLI MBIKQYRES

Z.Adrian ÇELA

KRYETAR

Z.Sotir NGRESI

N/KRYETAR

Z.Kujtim RUÇI

ANETAR

Z.Krenar HASANAJ

ANETAR

Z.Indrit BUKA

ANETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A.
ASAMBLEJA E AKSIONARËVE U. K. Durrës . SH.A

Nr. 579/1 Prot

Durrës 17/05/2019

V E N D I M

Nr. 4/1 Datë 17/05/2019

Asambleja e Aksionerëve në mbledhjen e tij të datës 17.05.2019, Njoftuar rregullisht me Njoftim me nr 801 prot, datë 23.04.2019; Bazuar ne Ligjin Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, VKM Nr 63 dt 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë te pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”,nenit 7 te Statutit te Shoqërisë;

Vendosi

1. Miratimin e ndryshimeve në Statutin e Shoqërisë U.K.Durrës sha, të nenit 6 pika 1, 2, 5 dhe nenit 9 pika 4, si me poshte;

Neni 6 Asambleja e Përgjithshme (AP) pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon;

Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga aksionarët zotërues të aksioneve të shoqërisë, që janë Njësitë e Pushtetit Vendor përkatëse.

Cilësia e aksionarit dhe e drejta e tij e votës në asamble ushtrohet nga Kryetari i Bashkisë ose përfaqësuesi i deleguar me autorizim prej tij.

Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon;

Pesha e votës e secilit prej anëtarëve të AP është në përpjestim me përqindjen e aksioneve sipas ndarjes territoriale administrative dhe gjendjes së regjistrimit në regjistrin tregtar pranë QKB.

Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon;

Thirrja e mbledhjeve të AP bëhet nëpërmjet lajmërimit me postë rekomande në adresën e secilit aksionar ose me postë elektronike nëse aksionari ka dhënë pëlqimin me shkrim për këtë mënyrë njoftimi duke bërë të njohur adresën elektronike të komunikimit.

Thirrja publikohet në faqen zyrtare internet të shoqërisë dhe dërgohet për botim në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

Neni 9 Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon;

Shoqëria nëpërmjet Administratorit kujdeset që 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë, përfshirë këtë ditë e mbledhjes, aksionereve t'u vihet në dispozicion thirrja dhe dokumentacioni i kërkuar prej tyre që ka lidhje me çështjet rend dite.

2. Rikonfirmimin për një mandat (tre) vjeçar të Anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë U.K.Durres sha Z.Kristaq Kikli dhe Z.Artion Beqiraj, duke ruajtur të njëjtin nivel të shpërblimit.
3. Rikonfirmimin e z.Spartak Kovaçi në detyrën e Anëtarit të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë U.K.Durres sha dhe caktimin si Administrator (Drejtor i Përgjithshëm) i shoqërisë, me mandat 3 (tre) vjeçar, duke ruajtur të njëjtin nivel të shpërblimit.
4. Miratimin e shtimit të numrit të punonjësëve me 34 punonjës, 10 prej të cilëve punonjës sezonal nga dt 01 korrik 2019, duke e çuar nr e punonjësëve 733 deri në fund të vitit 2019, si pasojë e marrjes në dorëzim të ujësjellësit të ri në Fushë Milot (stacioni i ri, puset dhe depot)
5. Miratimin e Rishikimit të Planit Operacional Financiar 2019.
6. Emerimin e Audituesit Ligjor Z.Arian Çyrbja me Nipt K 61509508 L, për paraqitjen e raportimit financiar, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për 6-mujorin e dytë të vitit 2018 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2019.
7. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë ose personi i autorizuar prej tij të ndjekë procedurat e regjistrimit pranë Q.K.B -së, të Vendimeve të Asamblese së Aksionarëve.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE TË U.K.SH.A DURRËS

AKSIONARËT	AKSIONE	PËRFAQËSUES
BASHKIA DURRËS	76/4%	<u>ANGJUSH DAKO</u>
BASHKIA SHIJAK	11.6 %	<u>Adrian Lolo</u>
BASHKIA KRUJË	6.8%	
BASHKIA VORË	2.8%	<u>Lulzim Ugonaj</u>
BASHKIA KURBIN	2.4%	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË
KRYETARI

Nr. 2458/prot.

Vorë, më 17.05.2019

AUTORIZIM

PËR

**“PËRFAQËSIM NË ASAMBLENË E AKSIONARËVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS
KANALIZIME DURRËS SH.A”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “për vetëqeverisjen vendore” nenin 64, gërma a, “Për kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë”, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” I ndryshuar, nenin 140 “Përfaqësimi në Asamble”, VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”,

AUTORIZOJ:

1. Z. Lulzim Vana, me detyrë Sekretar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë Vorë, të më përfaqësojë në mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Durrës sh.a, e cila zhvillohet në datë 17.05.2019.
2. Ky autorizim është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese të cilat kanë të njëjtin rend dite.

Kryetari
Erion ISMAILI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. 2473 prot.

Laç, me. 13/05 /2019

A U T O R I Z I M

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare " , I ndryshuar , VKM Nr.63, datë 27.01.2016 " Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura;

Autorizoj:

Përfaqësuesit e Sh.a Ujësjellës Kanalizime Kurbin z. Drilon Aliu dhe z. Gentjan Mehmeti të përfaqësojnë Bashkinë Kurbin në mbledhjen e Asamblesë Aksionere që zhvillohet me datë 17.05.2019 ora 10-30 në ambientet e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës .

Kryetari i Bashkise

Artur Bardhi